

## ZONA E SHENGENIT

Emri i Shengenit, një fshat i vogël në Luksemburg afër kufirit me Gjermaninë dhe Francën, është bërë sinonim i lëvizjes së lirë të njerëzve në Evropë.

Heqja e kontrolleve të kufijve të brendshëm ka ecur paralelisht me rregullat e përbashkëta për kontrollimin e kufijve të jashtëm dhe bashkëpunimin e përfunduar gjyqësor dhe policor për luftimin e krimit.

Çdo shtet në zonën Shengen vlerësohet rregullisht nga organet kompetente të BE-së për të kontrolluar nëse i zbaton në mënyrë korrekte rregullat e dakorduara.

Zona Shengen pa kontrolle të kufijve të brendshëm aktualisht i mbulon 27 vende (23 shtete anëtare të Bashkimit Evropian dhe 4 shtete të lidhura), të cilat e zbatojnë tërë të acquis të Shengenit.

Kufiri i jashtëm i zonës së Shengenit është mbi 50,000 km i gjatë (80 % det dhe 20 % tokë) dhe përfshin qindra aeroporte, porte detare dhe pika të kalimit kufitar tokësor.



Rue d e la Loi /We tstra at 175  
1048 Bruxelles • Brussel  
Belgique • België  
Tel. +32 (0)2 281 61 11



[consilium.europa.eu](https://consilium.europa.eu)

[f](#) [t](#) [i](#) [in](#) /eucouncil

Ky publikim është prodhu ar nga Sekretariati i Përgjithshëm i Kësh illit të Bashk imit Evr opian dhe është menduar vetëm për qëllime informative. Nuk e përfshin përgjegjësinë e institucioneve të BE-së dhe as të shteteve anëtare.

© Bashkimi Evropian, 2023

Harta e riprodhuar me lejen miqësore të Lovell Johns, Oksford, MB, [www.lovelljohns.com](http://www.lovelljohns.com).



Publications Office  
of the European Union



Council of the  
European Union

## SHENGENI

Porta jua për lëvizjen  
e lirë në Evropë



Print: ISBN 978-92-824-9188-1, doi:10.2860/332413, QC-04-23-067-EN-C – PDF: ISBN 978-92-824-9155-3, doi:10.2860/373077, QC-04-23-067-EN-N

## Zona e Shengenit

- **Acquis për Shengenin** zbatohet në tërësi për territoret evropiane të shteteve anëtare të BE-së në vijim: **Belgjikën, Republikën Çeke, Gjermaninë, Estoninë, Greqinë, Spanjën (përfshirë Ishujt Balears dhe Ishujt Kanarie), Francën, Kroacinë, Italinë, Letoninë, Lituaninë, Luksemburgun, Hungarinë, Maltën, Holandën, Austrinë, Poloninë, Portugalinë** (duke përfshirë **Madeiran dhe Azorët**), **Slloveninë, Sllovakinë, Finlandën dhe Suedinë**
- **Danimarka** është shtet anëtar i BE-së që ka pozicion të veçantë për sa i përket zbatimit të acquis të Shengenit. Asaj i duhet ta zbatojë tërë acquis të Shengenit, jo si ligj të BE-së, por si obligim sipas së drejtës ndërkombëtare. Si rrjedhojë, Danimarka nuk voton kur masat e Shengenit miratohen nga BE-ja.
- **Islanda, Lihtenshtajni, Norvegjia** (përveç Svalbardit) dhe **Zvicra**, të cilat nuk janë shtete anëtare të BE-së, janë të lidhura me zbatimin e acquis të Shengenit nëpërmjet Marrëveshjeve të Asociimit. Ato e kanë të drejtën për të qenë të pranishme dhe për të dhënë sugjerime gjatë përgatitjes së akteve të acquis të Shengenit që miratohen pastaj nga institucionet e BE-së. Ato duhet t'i zbatojnë të gjitha aktet e Shengenit pas miratimit të tyre nga.
- **Bullgaria, Rumania dhe Qipro** janë shtete anëtare të BE-së të detyruara nga i tërë acquis i Shengenit. Megjithatë, ato ende nuk i zbatojnë pjesët e acquis që kanë të bëjnë me mungesën e kontroleve në kufijtë e brendshëm, duke përfshirë visat. Bullgaria dhe Rumania janë gjithashtu të lidhura me Sistemin Informativ të Shengenit. Qiproja do të jetë plotësisht e lidhur me Sistemin Informativ të Shengen nga 23 korriku i vitit 2023. Kontrollat në kufijtë e brendshëm me këto shtete anëtare mund të hiqen vetëm si rezultat i ndonjë vendimi të miratuar nga Këshilli.
- **Irlanda** është shtet anëtar i BE-së që nuk merr pjesë në bashkëpunimin në kuadër të Shengenit. Megjithatë, ajo mund të kërkojë dhe të autorizohet që të marrë pjesë në disa pjesë të acquis të Shengenit për sa i përket bashkëpunimit policor dhe gjyqësor në çështjet penale. Sot, Irlanda i zbaton përkohësisht fushat e acquis të Shengenit në të cilat ka kërkuar të marrë pjesë, duke përfshirë Sistemin Informativ të Shengenit në lidhje me policinë

Lëvizjet për dhe nga **Ceuta** dhe **Melilla**, **Ishujt Faroe** dhe **Grenlanda** u nënshtrohen rregullave specifike.

Kufijtë me **Andorrën, Monakon, San Marinon dhe Qytetin e Vatikanit** u nënshtrohen rregullimeve specifike të kontrollit sipas së drejtës kombëtare ose ndërkombëtare.

